



**Peace
Corps**

NORTH MACEDONIA

Raporti Vjetor

2020





Peace Corps

Mesazhi i Drejtorit



Deborah Conner
Drejtore i Korpusit të Paqes
në Maqedoninë e Veriut

Në vitin 2020, pas më pak se dy muaj të shkurtër të programit normal, Korpusi i Paqes filloi një evakuim të paparë global të vullnetarëve të Korpusit të Paqes, prej të cilëve 105 ishin nga Maqedonia e Veriut. Në dhjetor të vitit 2019, grupi MAK 24 ishte betuar dhe ishin në vendqëndrimet e tyre vetëm për 98 ditë. Unë dua të falenderoj të gjithë ata njerëz që i përkrahën këta 105 vullnetarë të tejkalojnë në një ngjarje aq stresuese dhe me impakt të ndryshoj jetën e përditshme. Unë gjithashtu dua të falenderoj drejtorin e mëparshëm të Korpusit të Paqes Mark Hanifin dhe stafin që ishin pjesë e këtij evakuimi të vullnetarëve. Ne vareshim nga familjet nikoqire, komunitetet, bashkëpunëtorët, OJQ-të lokale dhe partnerët nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut. Faleminderit të gjithëve!

Dy projektet kryesore të Korpusit të Paqes, *Projekti për zhvillimi të komunitetit* dhe *Projekti për arsim gjithëpërfshirës dhe gjuhë angleze*, mbeten të fuqishme. Si rezultat i rishqyrtimit të programit në vitin 2020 projekti i përparimit të mësimdhënies në gjuhën angleze dhe projekti i nevojave të veçanta u kombinuan në një program – *arsim gjithëpërfshirës dhe gjuhë angleze*. Përveç kësaj, në mënyrë që të përmirësohet mësimdhënia në gjuhën angleze dhe mësimi në

gjuhën angleze, shkollat dhe komunitetet partnere të Korpusit të Paqes janë të përkrahura të rrisin kapacitetin e tyre në mënyrë që të integrojnë nxënës me nevoja të veçanta në shkollat e tyre dhe më gjërë në komunitet.

Zyra e Korpusit të Paqes në Maqedoninë e Veriut mbetet një udhëheqës global me aftësitë e saj të zhvillojë, përdor dhe të zbatojë trajnime dhe punëtori online. Para evakuimit, stafi i Korpusit të Paqes ishin me përvojë në procesin e inkuadrimin të më shumë modaliteteve të ndryshme për trajnime para nisjes, para shërbimit, gjatë shërbimit dhe në fund të shërbimit. Programi dhe stafi trajnues i Korpusit të Paqes kishin zhvilluar trajnime online që vullnetarët e Korpusit të Paqes të mund t'i përfundojnë si shtesë e sesioneve kreative në mënyrë personale që tashmë ishin implementuar. Duke shfrytëzuar këtë ekspertizë multifunkionale, ata ishin të gatshëm shpejt të zhvendosin fokusin e tyre dhe të përqendrojnë atë në punën ekskluzivisht përmes online trajnimeve dhe punëtorive në mënyrë që të ofrojnë mundësi mësimi për njerëzit e Maqedonisë së Veriut. Këtu merrnin pjesë mësimdhënësit, udhëheqës të shoqërisë civile, drejtorë të OJQ-ve, qytetarë, udhëheqës dhe bashkëpunëtorë të komunave, kështu që duke mundësuar që Korpusi i Paqes të mbajë pjesën më të madhe të programit i cili ishte vendosur para goditjes së pandemisë.

Stafi në zyrën e Korpusit të Paqes në Maqedoninë e Veriut e ka pranuar këtë mjedis jashtëzakonisht sfidues dhe ka lulëzuar në zhvillimin dhe demonstrimin e aftësive të reja dhe talentëve të ri. Ata kanë përkrahur njëri tjetrin dhe kanë vendosur bazat për kthimin e vullnetarëve, të cilët po na mungojnë shumë. Unë jam shumë krenare që jam bashkuar me një grup kaq të talentuar dhe të përkushtuar dhe duke pritur me padurim që të luaj pjesën time për përmbushjen e misionit tonë. Mendimet dhe lutjet e mia janë me qytetarët e Maqedonisë së Veriut, veçanërisht me ata që kanë qenë të goditur në aspekt negativ nga kjo pandemi e tmerrshme. Ne po e lëmë pas vitin 2020 me kujtime të hidhura dhe po presim vitin 2021 me eksitim dhe angazhim të ripërtërirë për misionin e Korpusit të Paqes në Maqedoninë e Veriut.

Shkurtimisht për Korpusin e Paqes

Në vitin 1961, Kryetari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Xhon F. Kenedi, themeloi Korpusin e Paqes për të promovuar paqen dhe miqësinë botërore dhe sfidoi amerikanët për të jetuar dhe punuar në vendet në zhvillim. Kaluan gati gjashtëdhjetë vjet nga formimi i Korpusit të Paqes, por misioni dhe roli i Korpusit të Paqes i bëri ballë testit dhe kohës. Tre qëllimet e Korpusit të Paqes mbeten po aq të rëndësishme aq sa ishin kur u formua ai:



Qëllimi 1: Të ndihmojë popujt e vendeve të interesuar të përmbushin nevojat për individë të trajnuar.

Qëllimi 2: Të promovojë kulturën dhe vlerat amerikane te vendet në të cilat vullnetarët shërbejnë.

Qëllimi 3: Të promovojë në Amerikë kulturën dhe vlerat e vendeve në të cilat vullnetarët shërbejnë.

Nga viti 1961, më shumë se 240 000 vullnetarë të Korpusit të Paqes kanë shërbyer në 142 vende, dhe kanë lënë trashëgimi vlera të përbashkëta, marrëdhënie të përmirësuara dhe zhvillim të qëndrueshëm në komunitet. Në vitin 2020 më shumë se 7334 amerikanë kanë qenë vullnetarë në 61 vende nëpër tërë botën, para evakuimit global.

Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut

Korpusi i Paqes formoi programin e tij në Maqedoninë e Veriut në vitin 1996, me ftesë të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut. Që atëherë, më shumë se 800 vullnetarë kanë shërbyer në shkolla, komuna, organizata qytetare dhe institucione publike për të përmbushur nevojat e ndryshme të komuniteteve në vend. Si mirënjohje për rëndësinë e Korpusit të Paqes për përmirësimin e miqësisë mes Maqedonisë së Veriut dhe SHBA-ve, si dhe për detyrimin dhe përkushtimin e vullnetarëve në shoqërinë maqedonase, kryetari i Maqedonisë së Veriut dhuroi Urdhërin e Meritës për Korpusin e Paqes në Maqedoninë e Veriut në vitin 2011.



Group: MAK 1, 1996

Në vitin 2020, gjatë disa muajve të parë para evakuimit, 105 vullnetarë kanë shërbyer në njërën prej dy projekteve të Korpusit të Paqes në Maqedoninë e Veriut: *Arsim gjithëpërfshirës dhe gjuhë angleze dhe zhvillim i komuniteteve*, me theks të veçantë në rininë dhe nevojat e veçanta.

Gjatë shërbimit të tyre në Maqedoninë e Veriut, vullnetarët njihen me kulturën lokale, mësojnë gjuhët lokale dhe në mënyrë aktive marrin pjesë në jetën shoqërore. Pas arritjes në Maqedoninë e Veriut, vullnetarët kalojnë nëpër një trajnim intenziv për gjuhën, kulturën dhe shkathtësitë teknike. Për të lehtësuar integrimin e tyre në komunitetet lokale, vullnetarët jetojnë me familje nikoqire lokale gjatë trajnimit fillestar, por edhe gjatë periudhës prej 6 deri 24 muaj të shërbimit të tyre. Korpusi i Paqes ka bërë implementimin e programit të tij në Maqedoninë e Veriut përmes bashkëpunimit direkt me disa partnerë shtetërorë dhe lokal të cilët janë aktiv në sferën e arsimit, zhvillimin e komunitetit, punën me të rinjtë dhe personat me nevoja të veçanta.

Evakuimi i vullnetarëve

Korpusi i Paqes është falenderues të ketë familje nikoqire, bashkëpunëtorë, mbikqyrës dhe miq të Korpusit të Paqes aq të përkushuar, të cilët ofruan ndihmën dhe përkrahjen e tyre për vullnetarët tonë gjatë periudhës së evakuimit. Në mars të vitit 2020, në përputhje me rekomandimet nacionale dhe botërore, 105 vullnetarë u



evakuuan për shkak të pandemisë nga virusi COVID-19. Prej atëherë, stafi i Korpusit të Paqes ka vazhduar të punojë dhe është angazhuar me partnerët lokal dhe nacional përmes punëtorive edukative online, Programit të Granteve të Vogla të Korpusit të Paqes dhe bashkëpunime individuale me organizata të ndryshme. Aktualisht, Korpusi i Paqes po punon që të përgaditet për rikthimin e vullnetarëve. Ne po presim me padurim që vullnetarët të rikthehen në shërbim posa shëndeti dhe siguria e vullnetarëve, stafit dhe komuniteteve nikoqire mund të garantohet.

Në vitin 2020, Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut ka bashkëpunuar me partnerët nacional në vijim: Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Agjencia për Rini dhe Sport, Kryqi i Kuq, Këshilli Rinor Nacional dhe Koalicioni i Organizatave Rinore SEGA, Shoqata e Skautëve, dhe Shoqata e Klubeve Rotari të Maqedonisë së Veriut.



Korpusi i Paqes në një shikim 2020




105 vullnetarë të korpusit të paqes në vitin 2020

48 vullnetarë të arsimit në gjuhën angleze

50 vullnetarë të zhvillimit të komunitetit

7 vullnetarë të arsimit gjithëpërfshirës



15 Punëtori virtuale për ndërtim të kapaciteteve

7 punëtori të Zhvillimit të komunitetit

8 punëtori të Arsim gjithëpërfshirës dhe gjuhë angleze

831 pjesëmarrës



9 Projekte të Granteve të Vogla

6 projekte SPA

2 projekte nga Programi i Partneritetit të Korpusit të Paqes

1 projekt nga Let Girls Learn



121 Vende që kishin vullnetarë

47 shkolla fillore

11 shkolla të mesme



34 OJQ, Organizata të Skautëve, Qendra Rinore, Shoqata Civile dhe Rotari Klube



5 organizata të Kryqit të Kuq



15 Komuna dhe institucione



2 Universitete



6 Qendra Ditore dhe OJQ për persona me aftësi të kufizuara



vite në Maqedoninë e Veriut

Projektet e Korpusit të Paqes

Projekti i Zhvillimit të Komunitetit



Projekti i zhvillimit të komunitetit në Maqedoninë e Veriut mbështet komunitetet dhe organizatat në Maqedoninë e Veriut me qëllim të arritjes së një zhvillimi më efikas të qëndrueshëm të komuniteteve. Në vitin 2020 vullnetarët e Korpusit të Paqes kanë punuar me organizatat qytetare, komunitat lokale dhe institucionet publike të vendit.

Duke punuar me partnerët lokal qëllimi i projektit të zhvillimit të komunitetit është që të ketë qytetarë aktiv dhe të angazhuar dhe organizatat e komunitetit në Maqedoninë e Veriut të udhëheqin përpjekje të qëndrueshme të zhvillimit që janë përfshirëse dhe të gjithë kategoritë e qytetarëve të përfitojnë nga ato.

Në vitin 2020, Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut ka thelluar bashkëpunimin me Shoqatën Nacionale të Skautëve dhe ka festuar njëvjetorin e bashkëpunimit me Shoqatën e Klubeve Rotari të Maqedonisë së Veriut. Rezultatet e hershme të këtij bashkëpunimi janë positive me rritje të numrit të bashkëpunimeve direkte mes klubeve dhe vullnetarëve në tetë komunitete të ndryshme.



Në fillim të vitit 2020, Korpusi i Paqes miratoi një plan bashkëpunimi me Agjensinë e Rinisë dhe Sportit, si dhe me Zyrën Regjionale të Bashkëpunimit Rinor (RYCO) në Shkup, që të përkrah të dy ekipet në përpjekjet dhe aktivitetet e tyre të lidhura me zhvillimin e rinisë në vend.

Vullnetarët për zhvillim të komunitetit në Maqedoninë e Veriut dhe bashkëpunëtorët e tyre lokal në vitin 2020 iu dhanë përparësi pojqekteve në vijim:

- Përkrahje të organizatave në vlerësimin e nevojave të komunitetit duke prezantuar dhe përdorur qasje pjesëmarrëse dhe inkluzive;
- Ndërtim i partneriteteve mes organizatave të ndryshme në komunitet;
- Lehtësim dhe organizim të aktiviteteve, siç janë kampet dhe klubet rinore për aftësitë e jetës dhe zhvillim të lidershit për të rinjtë.

Projektet e Korpusit të Paqes


Projekti i Arsimit gjithëpërfshirës dhe gjuhë angleze

Në periudhën mes janarit dhe marsit të vitit 2020, vullnetarët në projektin e arsimit gjithëpërfshirës dhe gjuhës angleze kanë punuar në shkolla fillore dhe të mesme, kryesisht me theks në komunitetet rurale dhe ato të marginalizuara. Vullnetarët e arsimit në gjuhën angleze i kanë ndihmuar arsimtarët në klasë me duke i njohur me metodologji klasore të përqëndruara tek nxënësit, qasje të reja në menaxhimin e klasës dhe ndihmë me klasa me shumë nivele. Përveç kësaj, kishte vullnetarë për nevoja të veçanta të vendosur në shkolla fillora që bashkëpunonin me edukatorët special në shkolla duke ndihmuar në përpjekje për praktika përfshirëse në shkollë.



Me rishqyrtimin nga viti i kaluar, projekti i arsimit në gjuhën angleze dhe programi për nevoja të veçanta, u bashkuan në një program të vetëm të quajtur Projekti për arsim gjithëpërfshirës dhe gjuhë angleze. Si rezultat i kësaj, Korpusi i Paqes filloi vendosjen e vullnetarëve nën dy qëllime të veçanta, për të ndihmuar nxënësit të mësojnë gjuhën angleze dhe për të përkrahur përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në shkolla.

Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut po e implementon projektin për arsim gjithëpërfshirës dhe gjuhë angleze në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Maqedonisë së Veriut dhe Byronë për Zhvillim të Arsimit, si dhe me agjensione dhe organizata tjera të përkushtuara për përmirësimin e mundësive arsimore për këta nxënës të marginalizuar.



Qëllimet e Projektit për arsim gjithëpërfshirës dhe gjuhë angleze janë: përmirësimi i mësimdhënies në shkolla, rritja e suksesit të nxënësve në mësimin e gjuhës angleze, forcimi i aftësive jetësore të nxënësve, përmirësimi i komunitetit shkollor, si dhe rritja e aftësive të shkollave për të aplikuar praktikën e klasës gjithëpërfshirëse, rritjen e aftësive jetësore dhe praktikave profesionale dhe përmirësimin e kapacitetit në përkrahje të përfshirjes në komunitet.



Trajnime online

Prej qershorit deri në dhjetor të vitit 2020, Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut organizoi 15 punëtori online për pjesëmarrësit në sektorët e arsimit dhe zhvillimit të komunitetit. Punëtoritë përfshyen tema të ndryshme, si p.sh: mësim efektiv online, metodologjitë e gjuhës angleze, dizajnim projektesh dhe menaxhim dhe baza e zhvillimit rinor - fillestar dhe i avancuar. Në total, punëtoritë sollën bashkë 831 pjesëmarrës nga sektorë të ndryshëm.

Seria e punëtorive të zhvillimit të komunitetit solli bashkë 327 pjesëmarrës nga komuna të ndryshme, shoqëria civile, institucione, mësues dhe qytetarë. Reagimet dhe pjesëmarrja e pjesëmarrësve gjatë punëtorive ka qenë e shkëlqyeshme dhe ne po presim me padurim të mirëpresim pjesëmarrës të ri, si dhe bashkëpunëtorët tanë në serine e re të punëtorive vitin e ardhshëm. Ne besojmë se punëtoritë janë të dobishme sepse përveç shkathtësive që janë të ndara me tjerët, punëtoritë janë një mundësi tjetër e madhe për zgjerimin e rrjetit të pjesëmarrësve duke njohur njerëz të rinj dhe organizata të reja, dhe të bashkëpunohet me ata në të ardhmen.

Seria e punëtorive të arsimit gjithëpërfshirës dhe gjuhë angleze ishin shumë të kërkuara nga mësimsdhënësit, si dhe nga profesionistët e sektorëve të tjerë. Në total, këto punëtori bashkuan rreth 500 profesionistë të arsimit nga shkolla të ndryshme fillore dhe të mesme.

Punëtorija jonë më e kërkuar e arsimit u mbajt në shtator, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Si reaktion i pandemisë së COVID-19 dhe nevojës për zgjerim të aftësive për mësimsdhënie në një ambient virtual, Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut organizoi dy punëtori online për mësimsdhënësit, të cilat ishin në dispozicion për të gjithë mësimsdhënësit në Maqedoninë e Veriut në temën *Mësim Efektiv Online*, duke mbuluar bazat e *Mësimi të kombinuar*, *Përdorimi i Zoom dhe Google Classroom si mjete efektive në mësimsdhënie*.



Në punëtori morën pjesë 310 pjesëmarrës nga 101 shkolla dhe 26 komunitete, dhe edhe më shumë mësimsdhënësit e morën inçizimin e punëtorisë, si dhe materialet e punëtorisë. Pjesëmarrja e mësimsdhënësit ishte nga pjesë të ndryshme të vendit, si p.sh. nga Shkupi (43 shkolla), Manastiri (10 shkolla), Kumanova (7 shkolla), Kërçova, Velesi, Gostivari, Prilepi, Dibra, dhe nga disa komunitete rurale siç janë Mogila, Bosilovo, Bogdanci, Negorci, Krivogashtani, Nagoriçi i Vjetër, Stajkovo, Gradsko.

Pjesëmarrësit theksuan se punëtori të këtij lloji janë shumë të dobishme dhe të nevojshme, posaçërisht në këtë periudhë të ndryshimeve ku ata mbajnë mësim online. Mësimsdhënësit shprehën nevojën për përkrahje në lëndët e tyre respektive dhe nevojën që të sigurohen me mjetet e nevojshme për lëndët e tyre. Tjetër nevojë e shprehur është mundësia e shkëmbimit të përvojave dhe ideve në punën e tyre. Më në fund, ky lloj i punëtorive duhet të organizohet në gjuhët lokale, në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.

Projekte të Granteve të Vogla

Konferenca virtuale për mjedisin jetësor

Edhe në kohë turbulente si kjo e pandemisë është shumë e rëndësishme të mos harrojmë ndryshimet klimatike, sigurinë dhe ndryshmërinë e ushqimit dhe shëndetin mjedisor. Duke filluar më 2010, vullnetarët e Korpusit të Paqes filluan Grupin Mjedisor të Punës i cili ka punuar ngushtë me Ajde Makedonija dhe Fondacionin Apollonia, dhe bashkarisht kanë drejtuar Konferencën Mjedisore në bazë vjetore. Në shtator të vitit 2020, partnerët tanë Ajde Makedonija dhe Fondacioni Apollonia vazhduan traditën dhe mbajtën konferencë 3 ditore online në temën “**Potencialet për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe promovimin e agrobiodiversitetit**”. Konferenca bashkoi rreth 50 pjesëmarrës çdo ditë në mënyrë që të diskutojnë çështjet kritike të agrobiodiversitetit dhe rëndësinë e ruajtjes së farës trashëguese. Folësit në konferencë ishin akademikë, përfaqësues të shoqërisë civile, biznese dhe aktivistë dhe vullnetarë.

The poster is for an online conference. At the top left is the logo for 'Ajde Makedonija' (Aide Macedonia) with a colorful smiley face. At the top right is the 'Apollonia Foundation' logo. The main text in the center reads: 'ON-LINE KONFERENCIJA' followed by 'Потенцијали за Зачувување, Одржување и Промоција на Агробидиверзитетот' (Potentials for Conservation, Maintenance and Promotion of Agro-biodiversity). Below the text is a circular image of various fresh fruits and vegetables. At the bottom, it specifies the dates '22, 23, 24 септември 2020' and time '14:00 - 15:30'. Logos for USAID and Peace Corps are also present.

Puna nuk përfundoi me këto tre ditë, partnerët tanë vazhduan duke krijuar një rrjet të fuqishëm të organizatave dhe individëve të përkushtuar që do të përipiqen të zhvillojnë këtë temë në komunitetet lokale dhe në politikat nacionale. Konferenca dhe krijimi i rrjetit kontribuan të rritet ndërgjegjësimi i publikut për potencialet që agrobiodiversiteti i ka për zhvillimin e ekonomisë dhe komuniteteve në Maqedoninë e Veriut.

Kamp i trajnim për aftësi jetësore në pjesën qendrore të Maqedonisë së Veriut

Ky është vetëm një shembull se si fondet SPA përmirësojnë ndërgjegjësimin e publikut për fëmijët me nevoja të veçanta dhe nevojat e prindërve dhe kujdestarëve të tyre. Ky grant ishte i përqendruar gjithashtu në përkrahje dhe inkurajim të edukatorëve për nevoja të veçanta duke zgjeruar njohuritë e tyre dhe duke zhvilluar mjete të reja që ata mund t'i përdorin në punën e tyre të përditshme. Projekti ishte i përkrahur nga komuniteti.

Granti kishte dy elemente kyçe:

- Trajnim për zhvillimin e aftësive për jetën për fëmijët me nevoja të veçanta
- Kamp pesëditor për nxënës me nevoja të veçanta dhe kujdestarët e tyre

Stafi shkollor dhe prindërit e nxënësve me nevoja të veçanta ishin të ftuar në trajnim për aftësi për jetën, i mbajtur nga një edukator special. Objektivat e trajnimit e rritën vetëdijësimin dhe praksën e prindërve duke i mësuar ata për aftësitë për jetën në shtëpi, duke trajnuar stafin në metodologji të mësimdhënies së aftësive për jetën në klasë, dhe duke krijuar marrëdhënie mes stafit dhe prindërve.



Kampi u mbajt në resortin Mihajllovo për 18 nxënës dhe prindërit e tyre, dhe për tre edukatorë special.

Trajnimi dhe kampi ishin tepër të suksesshëm. Prej ditës së parë me borë në malet e Mihajllovës, çdokush ishte i lumtur dhe i gatshëm të marrë pjesë. Çdo ditë përbëhej prej aktiviteteve të ndryshme, duke përfshirë art, lojëra, muzikë/vallëzim, si dhe aktivitete jashtë siç janë sport, hiking dhe aktivitete dimri në borë, të gjitha këto me theks në aftësitë për jetën dhe përfshirjen e mësimin të aftësive për jetën në aktivitetet ditore dhe përmes lojërave. Kampi kishte një ndikim të jashtëzakonshëm në aftësitë për jetën tek nxënësit, kujdesin për veten dhe përfshirjen në komunitet, por gjithashtu u ndihmoi prindërve të shohin kapacitetin e plotë të aftësive të fëmijëve të tyre. Në Maqedoninë e Veriut ka një mungesë motivimi kur kemi të bëjmë me

edukimin e personave me nevoja të veçanta, dhe ky kamp ndihmoi që të ndryshohet ajo pikëpamje tek shumë edukatorë dhe prindër, pasi që ata kishin mundësinë të shohin aktivitete të ndryshme të përshtatura që mund të bëhen me qëllim që të rriten aftësitë tek personat me çfarëdo kufizimi. Gjithashtu, duke përfshirë prindërit në kamp dhe trajnimet për aftësitë për jetën i bëri ata të ndjehen më të involvuar dhe zërin e tyre të dëgjuar sa i përket edukimit të fëmijëve të tyre. Kampi dhe trajnimi gjithashtu i bënë edukatorët special të ndjehen të eksituar për shkak të mësimin të aftësive për jetën në shkollë. Ky ishte granti i parë i këtij lloji dhe Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut planifikon ta përdor si shembull (ide) për vullnetarë të ardhshëm të Korpusit të Paqes që do të punojnë me njerëz me nevoja të veçanta. Ky projekt u implementua dhe përfundoi pak para evakuimit të vullnetarëve.

Përmirësimi i mundësive folklorike tek të rinjtë përmes arsimit ndërkulturor

Një komunitet i vogël rural shpreson të përmirësojë mundësitë kulturore për rininë e tij, posaçërisht në fushën e folklorit. Shtëpia e Kulturës Mirka Ginova, një institut kulturor maqedonas, është forca lëvizëse për të gjitha aktivitetet kulturore dhe në partneritet me Komunën e Demir Kapisë feston trashëgiminë e komunitetit duke mbajtur Manifestimin e Shën Trifunit më 14 shkurt. Përmes intervistave me palët e interesit dhe bisedave me të rinjtë, pjesëtarë të komunitetit identifikuan



nevojën për të krijuar një eksperincë ndërkulturore rreth Manifestimit të Shën Trifunit për të zgjeruar mundësitë folklorike lokale të të rinjve dhe të përmirësojnë ngërgjegjësimin kulturor të të rinjve duke krijuar partneritet me insitutin kulturor turk “Yeni Yol” nga Shkupi.

Aktivitetet e projektit përfshijnë Javën e Ndërgjegjësimit Kulturor në shkollën fillore “Dimçe Angellov - Gaberot” para manifestimit, një performance folklorike e përbashkët dhe punëtori ndërkulturore me të rinj maqedonas dhe turk në Manifestimin e Shën Trifunit, dhe fillim i trajnimeve për folklor tradicional turk në qytet pas manifestimit. Drejtori i shkollës fillore, mësues lokal turk, drejtori i Shtëpisë së Kulturës dhe një punonjës në komunë - udhëheqën aktivitetet duke dëshmuar përkrahjen e gjërë të komunitetit. Këto aktivitete së bashku me një projektor të ri dhe veshje tradicionale maqedonase do t'i japin stafit të Shtëpisë së Kulturës mjetet edukative dhe kapacitetin organizues të mësojnë kulturën turke dhe folklorin maqedonas gjeneratave të reja, duke përforcuar unitetin kulturor dhe duke ruajtur kulturën maqedonase në këtë qytezë të vogël.

Projekti përmirësoi vetëdijësimin kulturor and diturinë e rinisë lokale në qytet duke ekspozuar të rinjtë ndaj traditave dhe koreografive tradicionale turke dhe boshnjake. Në total, mbi 40 anëtarë të rinj të Shtëpisë së Kulturës ishin pjesë e aktiviteteve të projektit, duke tejkaluar qëllimin fillestar prej 25.



Sondazhe u shpërndan në shkolla fillore për të rinjtë pas ngjarjes folklorike ndërkulturore me valle tradicionale dhe poezi që theksonte si kulturën maqedonase, po ashtu edhe atë turke. Shumica e përgjigjeve në sondazh shprehën reagime positive për aktivitetet.

Kjo ngjarje, së bashku me aktivitetet tjera kulturore nga projekti, ishte e mirëpritur nga komuniteti me prindër, mësime dhënë dhe punonjës të qeverisë lokale.

Ambasadorja Kejt Bërns pret Pranimin e Partnerëve të Korpusit të Paqes

Më 10 mars, ambasadorja e SHBA-ve Kejt Bërns (Kate Byrnes) ishte nikoqirja e pranimin të partnerëve të Korpusit të Paqes. Mes mysafirëve të ftuar ishin partner aktual dhe të ardhshëm të Korpusit të Paqes në Maqedoninë e Veriut. Organizatat partnere të Korpusit të Paqes që ishin të pranishme kanë oda, zyra dhe/ose klube në të gjithë vendin. Pranimi u



mundësoi ambasadores Bërns dhe drejtorit Mark Hanafin që të shprehin mirënjohjen për partnerët aktual, për përkrahjen dhe përkushtimin e tyre gjatë viteve. Ngjarja mundësoi që të rritet dukshmëria e Korpusit të Paqes me partnerët nacional duke punuar në fushën e zhvillimit. Gjithashtu mundësoi një mundësi kryesore të promovojë mundësitë për organizatat lokale (komuna, organizata të shoqërisë civile dhe grass-root organizatave rinore) të punojnë me grupe të reja të vullnetarëve të Korpusit të Paqes.





**Peace
Corps**

NORTH MACEDONIA

